



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

STATUTI I FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Prishtinë, 23.03.2026



PËRMBAJTJA:

KREU I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	5
<i>NENI 1 - FEDERATA</i>	5
<i>NENI 2 - EMËRTIMI DHE SELIA</i>	5
<i>NENI 3 - STATUSI</i>	6
<i>NENI 4 - LOGOJA</i>	6
<i>NENI 5 - ANËTARËSIA E FBK-SË NË ORGANIZATA TË TJERA</i>	6
<i>NENI 6 - PËRFAQËSIMI I FEDERATËS</i>	7
<i>NENI 7 - TRANSPARENCA</i>	7
<i>NENI 8 - PARIMET E PËRGJITHSHME</i>	7
KREU II. QËLLIMET DHE VEPRIMTARIA E FEDERATËS	9
<i>NENI 9 - QËLLIMET SPORTIVE</i>	9
KREU III. ANËTARËT E FEDERATËS	10
<i>NENI 10 - ANËTARËSIA NË FEDERATË</i>	10
<i>NENI 11 - KUOTA VJETORE DHE SHUARJA E STATUSIT TË ANËTARËVE</i>	12
<i>NENI 12 - TË DREJTAT E ANËTARËVE</i>	13
<i>NENI 13 - OBLIGIMET E ANËTARËVE</i>	14
KREU IV. ORGANET E FEDERATËS	16
<i>NENI 14 - ORGANET E FEDERATËS</i>	16
KREU V. KUVENDI I FEDERATËS	16
<i>NENI 15 - VEPRIMTARIA</i>	16
<i>NENI 16 - TË DREJTAT E DELEGATËVE</i>	17
<i>NENI 17 - MANDATI I DELEGATËVE</i>	17
<i>NENI 18 - MBLEDHJET</i>	18
<i>NENI 19 - VENDIMET</i>	19
<i>NENI 20 - KOMPETENCAT</i>	19
KREU VI. BORDI I FEDERATËS	20
<i>NENI 21 - VEPRIMTARIA</i>	20
<i>NENI 22 - ANËTARËT E BORDIT</i>	21
<i>NENI 23 - MANDATI DHE PUSHIMI I MANDATIT</i>	21



NENI 24 - KOMPETENCAT	22
NENI 25 - TRUPAT PUNUES	25
KREU VII. KOMITETI EKZEKUTIV I FEDERATËS	25
NENI 26 - ANËTARËT, VEPRIMTARIA DHE KOMPETENCAT	25
KREU VIII. KRYETARI I FEDERATËS	27
NENI 27 - ZGJEDHJA DHE MANDATI I KRYETARIT	27
NENI 28 - KOMPETENCAT	28
KREU IX. SEKRETARI I PËRGJITHSHËM	28
NENI 29 - EMËRIMI DHE MANDATI I SEKRETARIT	28
NENI 30 - KOMPETENCAT	29
KREU X. KËSHILLI MBIKËQYRËS	30
NENI 31 - ANËTARËT DHE VEPRIMTARIA	30
KREU XI. KËSHILLI PROFESIONAL	31
NENI 32 - VEPRIMTARIA, ANËTARËT DHE KOMPETENCAT	31
NENI 33 - SHOQATA E BASKETBOLLISTËVE DHE SHOQATAT E TRAJNERËVE DHE GJYQATARËVE TË BASKETBOLLIT	32
KREU XII. PERSONI KONTAKTUES PËR INTEGRITET (SPOC) NË FEDERATËN E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS	33
NENI 34 - EMËRIMI DHE DETYRAT Kryesore	33
KREU XIII. FINANCIMI I FEDERATËS	33
NENI 35 - FINANCIMI DHE TË DREJTAT E TRANSMETIMIT AUDIO-VIZUAL	33
KREU XIV. GARAT	35
NENI 36 - GARA ZYRTARE	35
KREU XV. PËRFAQËSUESET SHTETËRORE	35
NENI 37 - PUNA PËR PËRFAQËSUESET SHTETËRORE	35
KREU XVI. SHËRBIMI ADMINISTRATIVO-PROFESIONAL	35
NENI 38 - FUNKSIONIMI I SHËRBIMIT ADMINISTRATIVO-PROFESIONAL	35
KREU XVII. RREGULLORET E BRENDSHME	36
NENI 39 - MOS-NDRYSHIMI I RREGULLOREVE GJATË EDICIONIT	36
NENI 40 - PROCEDURAT ADMINISTRATIVE	36



KREU XVIII. PUSHIMI I VEPRIMTARISË SË FEDERATËS..... 36

NENI 41 - PUSHIMI I AKTIVITETIT DHE SHPËRNDARJA E PASURISË..... 36

KREU XIX. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE 37

NENI 42 - PËRGJEGJËSITË NDAJ PARANDALIMIT DHE SANKSIONIMIT TË

DHUNËS DHE DUKURIVE NEGATIVE NË NGJARJET SPORTIVE..... 37

NENI 43 - MËNJANIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT 37

NENI 44 - MIRATIMI DHE HARMONIZIMI ME KËTË STATUT 37

NENI 45 - INTERPRETIMI I STATUTIT 38

NENI 46 - HYRJA NË FUQI..... 38





Në bazë të nenit 19 të Ligjit Nr. 08/L-277 për Sport dhe në bazë të nenit 20 të Ligjit Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-244, Kuvendi i Federatës së Basketbollit të Kosovës, me datë 23.03.2026 miraton këtë:

STATUT TË FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

KREU I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

NENI 1 - FEDERATA

- 1.** Federata e Basketbollit e Kosovës është asociacion vullnetar i pavarur i klubeve dhe shoqatave të themeluara nga qytetarët, me qëllim të interesave të veçanta dhe përbashkëta në lëminë e sportit të basketbollit, duke luftuar diskriminimin në çfarëdo baze.
- 2.** Federata e Basketbollit e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Federata) është institucioni më i lartë i sportit të basketbollit në Kosovë për meshkuj dhe femra, që për veprimtari themelore e ka sportin e basketbollit dhe organizimin e të gjitha garave në të gjitha kategoritë dhe disiplinat e basketbollit. Federata është e organizuar në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit për sportin e Kosovës.
- 3.** Themelimi i Federatës bazohet në parimet e shprehjes së vullnetit të lirë, mbrojtjes së interesave të sportit të basketbollit, sigurimit të drejtave të barabarta për të gjithë anëtarët dhe luftimit të diskriminimit në çfarëdo baze.
- 4.** Me anëtarësimin në Federatë, të gjithë anëtarët e saj, klubet, shoqatat dhe shkollat e basketbollit, pranojnë të drejtat, obligimet, përgjegjësitë, detyrimet dhe privilegjet e përcaktuara me këtë Statut.

NENI 2 - EMËRTIMI DHE SELIA

- 1.** Emri i Federatës është: Federata e Basketbollit të Kosovës. Shkurtesa e emrit të Federatës është: FBK.
- 2.** Selia e Federatës është në Prishtinë, ndërsa ajo vepron në tërë territorin e Kosovës.



NENI 3 - STATUSI

- 1.** Federata është subjekt juridik, i cili vepron në pajtueshmëri me Ligjin për sportin në Kosovë, Ligjin mbi organizatat jo fitimprurëse dhe aktet normative të zbatueshme në Federatën Ndërkombëtare të Basketbollit (FIBA).
- 2.** Federata është e regjistruar si organizatë jofitimprurëse pranë organit përgjegjës dhe është e licencuar pranë departamentit përkatës përgjegjës për sport.
- 3.** Federata ka xhirollogarinë e vet bankare dhe për obligimet dhe detyrimet e veta përgjigjet me të gjitha mjetet e saj.
- 4.** Federata ka logon, vulën dhe flamurin e vet.
- 5.** Federata ka vulën katrore dhe vulën e rrumbullakët, të cilat përdoren në pajtim me aktet normative të brendshme të Federatës.

NENI 4 - LOGOJA

- 1.** Logoja e Federatës përbëhet nga një skica e jashtme dhe vijëzimet e topit të basketbollit, të vendosur nën mbishkrimin Kosova dhe nën gjashtë yje të verdha të vendosura në prapavijë të kaltër.
- 2.** Logoja e Federatës është e mbrojtur dhe duhet të përdoret vetëm në të gjitha komunikimet zyrtare të Federatës. Përdorimi i logos së Federatës nga subjektet tjera mund të bëhet vetëm me leje paraprake të Bordit të Federatës.

NENI 5 - ANËTARËSIA E FBK-SË NË ORGANIZATA TË TJERA

- 1.** Federata është anëtare e Komitetit Olimpik të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KOK).
- 2.** Federata është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Basketbollit - FIBA dhe mund të anëtarësohet edhe në asociacione tjera sportive vendore dhe ndërkombëtare.
- 3.** Federata punon në bazë të akteve normative të saj, legjislacionit në fuqi në Kosovë dhe rregullativës së FIBA-s dhe KOK-ut.



4. Federata është organizatë apolitike dhe nuk mund të anëtarësohet në organizata apo parti politike.

NENI 6 - PËRFAQËSIMI I FEDERATËS

1. Federata përfaqësohet nga Kryetari i Federatës, Anëtarët e Bordit të Federatës dhe Sekretari i Përgjithshëm i Federatës.

2. Modalitetet dhe nivelet e përfaqësimit të Federatës përcaktohen me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të Federatës, të cilën e miraton Bordi i Federatës.

NENI 7 - TRANSPARENCA

1. Federata veprimtarinë e saj e kryen në mënyrë transparente. Zyrat e Federatës janë të hapura dhe punojnë me palë çdo ditë pune në Kosovë.

2. Federata informon anëtarët e saj, opinionin e gjerë dhe mediat për veprimtarinë e saj përmes informatorëve elektronikë, faqes së saj në internet dhe konferencave për shtyp.

NENI 8 - PARIMET E PËRGJITHSHME

1. Të gjitha veprimet e Federatës dhe anëtarëve të saj bazohen në parimet e përgjithshme si në vijim:

1.1. Basketbolli për të gjithë - çdo person ka të drejtë të merret me sportin e basketbollit, përfshirë aktivitetin fizik të ndërlidhur. FBK dhe anëtarët e saj promovojnë përfshirjen në sport, gjegjësisht në basketboll;

1.2. Ligjshmëria - veprimet duhet të jenë në përputhje me dispozitat e Ligjit ose legjislacionit tjetër përkatës në fuqi në Republikën e Kosovës. Çdo kufizim ose ndalim i një të drejte në fushën e sportit duhet të bazohet në ligj ose aktet normative të FBK-së;

1.3. Qeverisja e mirë - respektimi dhe zbatimi i Kodit të Qeverisjes së Mirë të përcaktuar me ligjin në Kosovë, respektimi i rregullave përkatëse etike dhe rregullave të tjera ndërkombëtare për qeverisjen e mirë;



1.4. Mos-diskriminimi - garantimi i pjesëmarrjes në sportin e basketbollit dhe në qasje në infrastrukturë sportive në përputhje me ligj dhe rregullat e tjera përkatëse, si dhe ndalimi i diskriminimit në çfarëdo baze të përcaktuar me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi;

1.5. Ambienti i sigurt dhe i favorshëm për të gjithë - ambientet në të cilat zhvillohen veprimtaritë sportive duhet të jenë të sigurta, ku të gjithë personat e përfshirë në sportin e basketbollit trajtohen me respekt, dinjitet dhe pa ngacmim si dhe në përputhje me standardet që mbrojnë shëndetin e tyre. Çdo dhunë, keqpërdorim, abuzim ose dukuri tjetër negative ndalohet dhe sanksionohet me ligj;

1.6. Transparenca - veprimet duhet të jenë transparente dhe dokumentet publike duhet të jenë të qasshme në përputhje me ligjin përkatës për qasjen në dokumente publike;

1.7. Mbrojtja e privatësisë - veprimet nuk cenojnë privatësinë dhe të dhënat personale të personave të përfshirë në aktivitet sportiv mbrohen në përputhje me ligjin përkatës;

1.8. Mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve - ndërmarrja e të gjitha masave mbrojtëse për fëmijët dhe të rinjtë pjesëmarrës në sportin e basketbollit, në të cilat përfshihen njoftimi i policisë, organit të kujdestarisë dhe organeve të tjera shtetërore përkatëse për çdolloj dhunë ndaj tyre, keqpërdorim, ngacmim ose sjellje tjetër të pahijshme;

1.9. Mbrojtja e mjedisit dhe siguria publike - ndërmarrja e të gjitha masave mbrojtëse për mjedisin dhe natyrën gjatë zhvillimit të veprimtarisë sportive, në përputhje me legjislacionin përkatës, si dhe mos-cenimi i sigurisë publike;

1.10. Fair-play - sporti i basketbollit zhvillohet në bazë të rregullave, konkurrencës së ndershme, respektit ndaj kundërshtarit, parandalimit dhe shmangies së dhunës dhe sjelljes jo të drejtë.



KREU II. QËLLIMET DHE VEPRIMTARIA E FEDERATËS

NENI 9 - QËLLIMET SPORTIVE

1. Federata funksionon duke marrë parasysh qëllimet e përcaktuara me këtë Statut. Federata shprehimisht zotohet se do të punojë për arritjen e qëllimeve të mëposhtme:

1.1. Masivizimi, zhvillimi cilësor dhe organizimi i sportit të basketbollit në Kosovë;

1.2. Sigurimi i kushteve për veprimtarinë e të gjitha kategorive të përfaqësueses kombëtare të Federatës;

1.3. Avancimi profesional i lojtarëve, trajnerëve, gjyqtarëve, vëzhguesve dhe akterëve tjerë në sportin e basketbollit;

1.4. Sigurimi i ndihmës për organizatat dhe subjektet tjera që kanë për qëllim promovimin e sportit të basketbollit, në përputhje me aktet normative të Federatës;

1.5. Organizimi i veprimtarisë sportive në basketboll për të gjitha kategoritë dhe gjinitë, si dhe përcaktimi i sistemeve të garave për të njëjtat;

1.6. Avancimi i sportit të basketbollit përmes pjesëmarrjes në gara dhe evenimente ndërkombëtare;

1.7. Mbështetja e zhvillimit të basketbollit në tërë territorin e Kosovës, me theks të veçantë në viset ku ai është më pak i zhvilluar;

1.8. Organizimi i kampeve, seminareve, punëtorive, publikimeve profesionale, etj. me qëllim të avancimit të sportit të basketbollit;

1.9. Sigurimi i bazës materiale për zhvillimin e veprimtarisë së Federatës, si dhe për mbështetjen e klubeve dhe anëtarëve të saj;

1.10. Luftimi i përdorimit të dopingut dhe substancave të ndaluara, në përputhje me aktet normative të KOK-ut, FIBA-s, dhe me Rregulloren për Anti-Doping të FBK-së;



1.11. Sigurimi i pjesëmarrjes së përfaqësueseve dhe klubeve të Kosovës në gara dhe turne ndërkombëtare;

1.12. Adoptimi dhe promovimi i vlerave olimpike.

2. Federata nuk kufizohet në ndërmarrjen e veprimeve vetëm për arritjen e caqeve të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni.

KREU III. ANËTARËT E FEDERATËS

NENI 10 - ANËTARËSIA NË FEDERATË

1. Anëtarë të Federatës janë klubet dhe shkollat e basketbollit, Shoqata e Trajnerëve të Basketbollit, Shoqata e Basketbollistëve, Shoqata e Gjyqtarëve të Basketbollit, si dhe të gjitha klubet, shkollat e shoqatat tjera të cilat pranohen dhe licencohen në Federatë.

2. Anëtarësia e klubeve në Federatë sigurohet pas plotësimit të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme të anëtarësimit nga ana e subjektit që aplikon për regjistrim, të cilat janë të përcaktuara në vijim:

2.1. regjistrimi i subjektit si organizatë joqeveritare apo shoqëri tregtare, në përputhje me ligjet përkatëse;

2.2. statuti dhe aktet tjera normative për themelimin e klubit sportiv të miratuara;

2.3. strukturat qeverisëse të themeluara dhe personat që angazhohen në organet drejtuese të mos e kenë të ndaluar të ushtrojnë këtë veprimtari sipas ligjit në fuqi në Republikën e Kosovës;

2.4. vendimi i komunës me të cilin dëshkohet selia e klubit ku ushtron veprimtarinë sportive bazë të tij;

2.5. posedimi i infrastrukturës optimale për ushtrimin e veprimtarisë sportive të klubit, që vërtetohet nga menaxheri i infrastrukturës përkatëse;

2.6. lista e sportistëve që janë pjesë e klubit dhe trajnerin e angazhuar që plotëson kushtet e përcaktuara me Ligjin për Sport;



2.7. dokumentet përcjellëse të nevojshme sipas rregulloreve përkatëse të Federatës.

3. Anëtarësia e shoqatave në Federatë sigurohet pas plotësimit të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme të anëtarësimit nga ana e subjektit që aplikon për regjistrim, të cilat janë të përcaktuara në vijim:

3.1. regjistrimi i subjektit si organizatë jo-qeveritare, në përputhje me ligjin përkatës;

3.2. statuti dhe aktet tjera normative për themelimin, të miratuara;

3.3. strukturat qeverisëse të themeluara dhe personat që angazhohen në organet drejtuese të mos e kenë të ndaluar të ushtrojnë këtë veprimtari sipas ligjit në fuqi në Republikën e Kosovës;

3.4. dokumentet përcjellëse të nevojshme sipas rregulloreve përkatëse të Federatës.

4. Anëtarësia e shkollave të basketbollit sigurohet pas plotësimit të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme të anëtarësimit nga ana e subjektit që aplikon për regjistrim, të cilat janë të përcaktuara në vijim:

4.1. regjistrimi i subjektit si shoqëri tregtare, në përputhje me ligjin përkatës;

4.2. statuti dhe aktet tjera normative për themelimin, të miratuara;

4.3. vendimi i komunës me të cilin dëshmohet selia e shkollës ku ushtron veprimtarinë sportive bazë të tij;

4.4. strukturat qeverisëse të themeluara dhe personat që angazhohen në organet drejtuese të mos e kenë të ndaluar të ushtrojnë këtë veprimtari sipas ligjit në fuqi në Republikën e Kosovës;

4.5. posedimi i infrastrukturës optimale për ushtrimin e veprimtarisë sportive të shkollës, që vërtetohet nga menaxheri i infrastrukturës përkatëse;

4.6. lista e sportistëve që janë pjesë e shkollës dhe trajnerin e angazhuar që plotëson kushtet e përcaktuara me Ligjin për Sport;



4.7. dokumentet përcjellëse të nevojshme sipas rregulloreve përkatëse të Federatës.

5. Anëtarësia në Federatë do të miratohet përkohësisht nga Bordi i Federatës, ndërsa pranimin përfundimtar të anëtarëve të rinj në Federatë e bën Kuvendi i Federatës në mbledhjen e radhës, me më tepër se 50% të votave të delegatëve të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit.

6. Klubet që garojnë në të njëjtin rang të garave mund të organizohen në shoqata/asociacione të ligave përkatëse, me leje të Bordit të FBK-së.

7. Për kompetencat e shoqatave/asociacioneve të klubeve/ligave vendoset me marrëveshje të veçantë me Bordin e FBK-së.

NENI 11 - KUOTA VJETORE DHE SHUARJA E STATUSIT TË ANËTARËVE

1. Të gjithë anëtarët e Federatës obligohen të paguajnë kuotën vjetore të anëtarësisë, të cilën e cakton Bordi i Federatës.

2. Statusi i anëtarit përfundon në rast të dorëheqjes, përjashtimit, apo shkrirjes së anëtarit, siç specifikohet në alinetë në vazhdim. Në rast të përfundimit të statusit të anëtarit, anëtari detyrohet të kthejë të gjitha asetet që i përkasin Federatës. Kjo përfshin, por nuk kufizohet vetëm në, burimet financiare, pajisjet sportive ose çdo pronë tjetër që mund të jetë dhënë nga Federata gjatë periudhës së anëtarësisimit.

3. Anëtari i FBK-së mund të heqë dorë nga anëtarësia, duke bërë kërkesën me shkrim 6 muaj më parë dhe në fund të vitit financiar. Kërkesa përcillet në Kuvendin e radhës pasi që anëtari në dorëheqje t'i përmbushë të gjitha obligimet financiare ndaj FBK-së.

4. Anëtari i Federatës mund të përjashtohet nga Federata në rast të shkeljes së Statutit apo akteve tjera normative të Federatës. Vendimin preliminar për pezullimin e anëtarësisë së anëtarëve e merr Bordi i Federatës, ndërsa vendimin për përjashtimin e miraton Kuvendi i Federatës me vendim të më tepër se 50% të delegatëve të pranishëm në Kuvend.



5. Shkrija e subjektit (ligjor) të një anëtarit mund të jetë vullnetare ose ligjore dhe humbë statusin e anëtarit edhe përpara arritjes së momentit të likuidimit.

6. Anëtarësia në Federatë konsiderohet e pezulluar për të gjitha klubet të cilat nuk marrin pjesë në garat e organizuara për stinorin aktual, apo të cilat nuk kanë marrë pjesë në gara përgjatë tërë stinorit paraprak në rastet kur mbledhja e Kuvendit mbahet gjatë pauzës në mes stinorëve. Në rast të tillë, delegatët e klubeve në Kuvendin e Federatës mund të jenë pjesëmarrës në cilësinë e vëzhguesit dhe pa të drejtë vote. Anëtarësia konsideruar e ndërprerë për të gjitha klubet që nuk marrin pjesë në dy stinor të njëpasnjëshëm garues.

7. Federata do të angazhohet për ruajtjen e statusit të anëtarësisë brenda një periudhe të arsyeshme kohore që do të caktohet nga vetë FBK, përmes zhvillimit të diskutimeve të drejtpërdrejta ose, kur është e nevojshme, përmes ndërmjetësimit. Këto procese kanë për qëllim adresimin e mosmarrëveshjeve ose shqetësimeve që ndikojnë në vazhdimësinë e anëtarësisë në mënyrë të drejtë dhe konstruktive.

NENI 12 - TË DREJTAT E ANËTARËVE

1. Anëtarët e FBK-së kanë të drejtë të:

1.1. marrin pjesë në Kuvendin e FBK-së (me anë të delegatëve), të thirren në kohën e caktuar me Statut, të jenë të njohur me rendin e ditës dhe të shfrytëzojnë të drejtën e tyre të votës;

1.2. japin propozime për ndërrimin dhe plotësimin e rendit të ditës në Kuvend;

1.3. propozojnë kandidatët për të gjitha organet e FBK-së, dhe mundësia të zgjidhen vet në pozita tjera në organet e Federatës, konform këtij Statuti;

1.4. kërkojnë kuvendin e jashtëzakonshëm me mbështetjen e 2/3 të anëtarëve të tjerë delegatë;

1.5. jenë të informuar mbi aktivitetet e FBK-së nëpërmjet trupave zyrtarë;



1.6. marrin pjesë në garat dhe aktivitetet tjera të organizuara nga FBK;

1.7. i realizojnë të gjitha të drejtat që dalin nga ky Statut, dhe nga vendimet dhe aktet tjera normative të FBK-së.

NENI 13 - OBLIGIMET E ANËTARËVE

1. Obligimet e Anëtarëve të FBK-së, ndër të tjera, janë:

1.1. t'i përmbahen Statutit, rregulloreve, akteve tjera normative dhe vendimeve të FBK-së, FIBA-së, KOK-ut, dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe që të sigurojnë që këtë do ta bëjnë edhe anëtarët e saj;

1.2. të jenë korrekt ndaj FBK-së dhe të paguajnë të gjitha detyrimet financiare ndaj saj;

1.3. t'i komunikojnë FBK-së çdo ndryshim eventual në aktet e saja normative dhe në listën e personave zyrtarë dhe të të autorizuarëve për nënshkrim;

1.4. t'i respektojnë rregullat e lojës së FIBA-së, dhe Kodin Etik të Federatës dhe FIBA-së;

1.5. të sigurojnë se aktet normative të tyre të parashohin që, të gjitha mosmarrëveshjet në nivel nacional do t'ia drejtojnë, si instancë e fundit, komisionit për arbitrazh të KOK-ut, dhe rrjedhimisht të njohin kompetencën e Gjykatës së arbitrazhit sportiv (CAS) në Lozanë, Zvicër;

1.6. të sigurojnë zgjedhje të lira për organet e veta ekzekutive;

1.7. të marrin pjesë në Kuvendin e FBK-së, e rrjedhimisht të zgjedhin apo kandidojnë delegatët e vet për Kuvend;

1.8. të marrin pjesë në garat apo aktivitetet e organizuara nga FBK-ja, qoftë në nivel nacional qoftë në atë ndërkombëtar, konform kalendarit zyrtar dhe propozicioneve të garave;



- 1.9.** pranimi i përgjegjësisë në bazë të Rregullores Disiplinore në rast të mos-përmbushjes së obligimeve apo thyerjes së rregullave që rrjedhin nga aktet normative të FBK-së dhe të organeve të saj;
 - 1.10.** të udhëheqin evidencën e regjistrimit të të gjithë anëtarëve të vet;
 - 1.11.** të bashkëpunojnë në mënyre të plotë me FBK-në, me organet dhe trupat e saj me qëllim të zhvillimit të lojës së basketbollit;
 - 1.12.** të respektojnë integritetin dhe unitetin e FBK-së;
 - 1.13.** të respektojnë principet e besnikërisë, integritetit, frymës sportive dhe fair-playit, përfshirë këtu edhe luftimin kundër dopingut dhe dukurive tjera negative në sport;
 - 1.14.** të mos ketë kurrfarë lidhje të natyrës sportive me trupat të cilët nuk janë të njohura, me anëtarët e suspenduar apo të larguar;
 - 1.15.** të mos lejojnë diskriminimin e çdo lloji kundër vendit, personave privat apo grupeve, në bazë të përkatësisë etnike, racore, gjuhësore, religjioze, gjinore, politike, apo për arsye tjera;
 - 1.16.** për çdo kontakt me organet e FIBA-së, të marrin pëlqimin paraprak të FBK-së;
 - 1.17.** të respektojnë të gjitha ligjet në fuqi në fuqi të Republikës së Kosovës.
- 2.** Kryerja e këtyre obligimeve i nënshtrohet edhe dispozitave të tjera në këtë Statut dhe akteve tjera normative në fuqi të FBK-së.
 - 3.** Mos-përmbushja e obligimeve të lartpërmendura nga ana e cilitdo anëtarë mund të sjellë deri te sanksionet apo përjashtimi konform këtij Statuti.



KREU IV. ORGANET E FEDERATËS

NENI 14 - ORGANET E FEDERATËS

1. Federata e zhvillon veprimtarinë e saj përmes organeve të krijuara me këtë Statut. Organet e Federatës janë:

- 1.1.** Kuvendi i Federatës;
- 1.2.** Bordi i Federatës;
- 1.3.** Kryetari i Federatës;
- 1.4.** Këshilli Mbikëqyrës i Federatës;
- 1.5.** Komisioni Disiplinor i Federatës; dhe
- 1.6.** Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit i Federatës.

KREU V. KUVENDI I FEDERATËS

NENI 15 - VEPRIMTARIA

- 1.** Kuvendi i Federatës është organi më i lartë i Federatës.
- 2.** Kuvendin e Federatës e përbëjnë delegatët e autorizuar të anëtarëve të Federatës dhe Kryetari i Federatës.
- 3.** Numri i delegatëve të ftuar në Kuvend do të jetë si në vijim:
 - 3.1.** Klubet e Superligës për Meshkuj - nga 2 delegatë;
 - 3.2.** Klubet e Superligës për Femra - nga 1 delegat;
 - 3.3.** Klubet e Ligës së Parë për Meshkuj - nga 1 delegat;
 - 3.4.** Shoqata e Trajnerëve të basketbollit - 1 delegat;
 - 3.5.** Shoqata e Basketbollistëve - 1 delegat;
 - 3.6.** Shoqata e Gjyqtarëve të basketbollit - 1 delegat;



3.7. Shoqatat tjera të pranuar në Federatë - 1 delegat.

4. Kuvendi punimet e veta i zhvillon në mbledhje, në të cilat ftohen të gjithë anëtarët e Federatës, të cilët kanë të drejtë vote apo janë në cilësinë e vëzhguesit në pajtim me nenin 10 të këtij Statuti. Mbledhja e Kuvendit mbahet nëse janë të pranishëm më tepër se gjysma e delegatëve të ftuar.

5. Në mbledhje të Kuvendit ftohen të marrin pjesë edhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Federatës, por pa të drejtë vote.

6. Mbledhjet e Kuvendit janë të hapura për publikun dhe mediat, dhe në to mund të ftohen edhe mysafirë të tjerë, të cilët nuk kanë të drejtë vote.

7. Kuvendi i Federatës miraton Rregulloren e Punës së Kuvendit të Federatës, e cila rregullon në mënyrë të detajuar procedurat dhe modalitetet e punës së Kuvendit të Federatës.

NENI 16 - TË DREJTAT E DELEGATËVE

1. Çdo delegat në Kuvend, i autorizuar paraprakisht nga klubet dhe shoqatat anëtare, ka të drejtë në një votë.

2. Delegatët në Kuvend mund të zgjidhen në pozita tjera në organet e Federatës. Anëtari i Federatës mund të zëvendësojë delegatët e vet edhe gjatë mandatit, duke e informuar Federatën me shkrim mbi delegatin zëvendësues. Shpenzimet e pjesëmarrjes së delegatëve në Kuvend i bartin Anëtarët që i kanë deleguar të njëjtit.

3. Numri i përgjithshëm i delegatëve të ftuar për mbledhje të Kuvendit do tu njoftohet delegatëve para çdo mbledhjeje të Kuvendit nga kryesuesi i saj.

NENI 17 - MANDATI I DELEGATËVE

1. Mandati i delegatëve në Kuvend zgjatë katër (4) vjet. Delegati i përgjigjet anëtarit të Federatës që e ka deleguar dhe Kuvendit ku ai ushtron detyrën e delegatit.

2. Delegimi mund të revokohet nga Anëtari edhe para mandatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni. Njoftimi mbi revokimin e mandatit do t'i dorëzohet Federatës në formë të shkruar nga Anëtari. Në të njëjtin



njoftim, Anëtari obligohet të delegojë delegatin zëvendësues për Kuvend. Njoftimi në fjalë duhet të dërgohet së paku një javë para mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit të Federatës.

NENI 18 - MBLEDHJET

- 1.** Mbledhjet e Kuvendit mund të jenë të rregullta dhe të jashtëzakonshme.
- 2.** Kuvendi i rregullt mbahet sipas nevojës, por më së paku një (1) herë në vit. Kuvendin e rregullt e konvokon Bordi me vendim.
- 3.** Kuvendin e jashtëzakonshëm mund ta thërret Kryetari, Bordi, dy të tretat (2/3) e Anëtarëve të Federatës, ose Këshilli Mbikëqyrës i Federatës. Kuvendi i jashtëzakonshëm mund të vendosë vetëm për çështjet për të cilat është konvokuar.
- 4.** Kuvendin e jashtëzakonshëm duhet ta thërrasë Kryetari i Federatës jo më vonë se 30 ditë pas konvokimit të tij nga organet e Federatës sipas paragrafit 3 të këtij neni. Në rast të mos konvokimit të Kuvendit të Jashtëzakonshëm nga Kryetari i Federatës, atë mund ta konvokojë edhe organi i Federatës që e ka iniciuar konvokimin e tij. Mos konvokimi i Kuvendit të Jashtëzakonshëm nga Kryetari i Federatës sipas dispozitave të këtij neni konsiderohet shkelje e rëndë e Statutit.
- 5.** Ftesa për mbledhje të Kuvendit duhet tu dërgohet të gjithë Anëtarëve më së largu 14 ditë para mbledhjes, ndërsa materiali që do shtjellohet në mbledhje së paku 7 ditë para mbledhjes.
- 6.** Federata e Basketbollit të Kosovës mund të organizojë mbledhjet e Kuvendit në formë hibride ose online, kur rrethanat e jashtëzakonshme apo nevojat e veçanta të organizimit e kërkojnë një gjë të tillë. Pjesëmarrësit në këto mbledhje do të konsiderohen të pranishëm dhe me të drejtë vote në përputhje me procedurat e përcaktuara nga Rregullorja e Punës së Kuvendit, me kusht që të përdoren mjete teknologjike që sigurojnë identifikimin dhe pjesëmarrjen e plotë të anëtarëve dhe votim të sigurt dhe transparencë. Çdo vendim i kësaj natyre duhet të miratohet nga Bordi i FBK-së dhe të raportohet në Kuvendin e ardhshëm të rregullt për miratim.



7. Me synim ruajtjen e plotë të integritetit procedural mbi çështjet me ndjeshmëri më të lartë, pikat në vijim nuk mund të vendosen në mbledhjet e Kuvendit të mbajtura në formë online:

7.1. Ndryshimet e këtij Statuti;

7.2. Zgjedhjet për Kryetar dhe Anëtarë të Bordit të FBK-së;

7.3. Pranimi ose përjashtimi i Anëtarëve të Federatës.

NENI 19 - VENDIMET

1. Kuvendi zgjedhë kryesinë e punës dhe organet tjera punuese me rastin e fillimit të mbledhjes së Kuvendit. Kryesinë e punës në mbledhjet e Kuvendit do ta përbëjnë Kryetari i Federatës dhe dy delegatë të Kuvendit.

2. Kuvendi mund të bie vendime në qoftë se janë të pranishëm më shumë se gjysma e delegatëve të Kuvendit. Vendimet konsiderohen të miratuara nëse për to kanë votuar më shumë se gjysma e delegatëve të pranishëm në mbledhje. Përjashtimisht kësaj dispozite, ndryshimi i këtij Statuti dhe vendimi për pushimin e veprimtarisë së Federatës do të bëhet nga 2/3 e delegatëve të Kuvendit. Votimi në Kuvend është publik, përveç nëse Kuvendi vendos ndryshe.

3. Vendimet e Kuvendit janë të obligueshme për të gjithë Anëtarët dhe organet e Federatës.

NENI 20 - KOMPETENCAT

1. Kuvendi i Federatës, si organi më i lartë i saj, bartë përgjegjësitë në vijim:

1.1. Miraton dhe ndryshon Statutin e Federatës;

1.2. Miraton Rregulloren e Punës së Kuvendit të Federatës;

1.3. Miraton Rregulloren e Punës së Bordit të Federatës;

1.4. Miraton Rregulloren e Punës së Këshillit Mbikëqyrës;

1.5. Miraton Rregulloren e Punës së Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit;



- 1.6.** Miraton raportet e punës së organeve të veta;
 - 1.7.** Sajon politikat e Federatës;
 - 1.8.** Miraton Strategjinë e Federatës;
 - 1.9.** Miraton planin financiar dhe raportin financiar vjetor;
 - 1.10.** Verifikon mandatin e delegatëve të autorizuar në Kuvend;
 - 1.11.** Miraton pranimin e Anëtarëve të rinj dhe pushon anëtarësinë e Anëtarëve aktual të Federatës, me më tepër se 50% të votave të delegatëve të pranishëm në Kuvend;
 - 1.12.** Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe anëtarët e Bordit;
 - 1.13.** Zgjedh dhe shkarkon Këshillin Mbikëqyrës;
 - 1.14.** Zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit;
 - 1.15.** Vendos mbi faljen e dënimeve;
 - 1.16.** Kryen punë tjera, në përputhje me Statutin dhe aktet tjera normative të Federatës.
- 2.** Kuvendi me vendim të veçantë mund t’ia delegojë Bordit të Federatës ndonjë nga kompetencat e veta.

KREU VI. BORDI I FEDERATËS

NENI 21 - VEPRIMTARIA

- 1.** Bordi është organi më i lartë ekzekutiv i Federatës, i cili udhëheq me punën e Federatës mes dy mbledhjeve të Kuvendit të saj. Bordi për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Federatës.
- 2.** Mënyra dhe procedurat e punës së Bordit të Federatës përcaktohen me Rregulloren e Punës së Bordit.



NENI 22 - ANËTARËT E BORDIT

1. Bordi numëron gjithsej 15 anëtarë dhe përbëhet nga: Kryetari, dy (2) nënkryetarë dhe dymbëdhjetë (12) anëtarë. Dy (2) anëtarë të Bordit duhet të jenë përfaqësues të sportistëve.

2. Kryetari, dy (2) nënkryetarët dhe shtatë (7) anëtarë të Bordit i zgjedhë Kuvendi me shumicë votash. Së paku një nga anëtarët e Bordit të zgjedhur nga Kuvendi duhet të jenë të gjinisë femërore. Dy (2) anëtarë të Bordit, në cilësinë e përfaqësuesve të sportistëve, zgjidhen nga Kuvendi me propozim të Shoqatës së Basketbollistëve dhe Basketbollisteve, ku njëri përfaqëson kategorinë e meshkujve dhe tjetri kategorinë e femrave. Tre (3) anëtarë të Bordit, nga të cilët së paku një i gjinisë femërore, emërohen dhe shkarkohen me vendim të Kryetarit të Federatës pas marrjes së postit të Kryetarit. Mandati i anëtarëve të Bordit të emëruar nga Kryetari i Federatës është i lidhur me mandatin e Kryetarit të Federatës, që do të thotë se mandati i tyre pushon në rast të pushimit të mandatit të Kryetarit të Federatës për çfarëdo arsye.

3. Procedura e zgjedhjes së kryetarit, nënkryetarëve dhe anëtarëve të Bordit nga Kuvendi i Federatës përcaktohet në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Federatës.

4. Përfaqësimi gjinor në Bordin e Federatës duhet të jetë në pajtim me dispozitat ligjore mbi sportin në Kosovë.

NENI 23 - MANDATI DHE PUSHIMI I MANDATIT

1. Bordi zgjidhet me mandat të plotë katër (4) vjeçar, sipas ciklit olimpik të Lojërave Olimpikë Verore, në pajtueshmëri me Statutin e Komitetit Olimpik të Kosovës. Anëtarët e Bordit ose i tërë Bordi mund të shkarkohen nga Kuvendi edhe para skadimit të mandatit, në qoftë se vërtetohet se të njëjtit kanë punuar në kundërshtim me ligjin, këtë Statut dhe aktet e tjera normative të Federatës.

2. Në rast të shkarkimit të tërë Bordit, Bordi i ri që zgjidhet ka mandat deri në fund të ciklit aktual olimpik të Lojërave Olimpikë Verore.

3. Në rast të pushimit të mandatit të anëtarit të Bordit të zgjedhur nga Kuvendi, për çfarëdo arsye, Kuvendi do ta zëvendësojë të njëjtin në takimin e parë të



radhës. Mandati i anëtarit të Bordit të zgjedhur nga Kuvendi që nuk merr pjesë në tri (3) mbledhje të Bordit mund të konsiderohet i pezulluar, me kërkesë të Kryetarit ose me vendim të Bordit. Anëtari për të cilin Bordi ka vendosur që t'ia pezullojë mandatin shkarkohet në Kuvendin e radhës dhe zëvendësohet me një anëtar të ri.

4. Në rast të pushimit të mandatit të anëtarit të Bordit të emëruar nga Kryetari, për çfarëdo arsye, Kryetari do ta emërojë anëtarin e ri të Bordit brenda jo më vonë se 30 ditësh nga pushimi i mandatit.

5. Në rast të dorëheqjes apo shkarkimit të tërë Bordit, apo shumicës së anëtarëve të tij, Kuvendi do të zgjedhë një trup udhëheqës (Këshilli i Përkohshëm Udhëheqës) nga radha e delegatëve të Kuvendit, të përbërë nga 5 anëtarë, i cili do të kryejë funksionet e Bordit deri në mbledhjen e radhës së Kuvendit, në të cilën do të zgjedhën organet e reja. Afati për mbajtjen e mbledhjes së tillë të Kuvendit nuk mund të jetë më vonë se 90 ditë nga dita e zgjedhjes së trupit punues në fjalë. Në rast të tillë, përgjegjës për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Federatës dhe organizimin e Kuvendit janë Këshilli i Përkohshëm Udhëheqës, Sekretari i Përgjithshëm i Federatës dhe punonjësit e shërbimit administrativ profesional të saj.

6. Bordi, së paku një herë në vit, për punën e vet i raporton Kuvendit të Federatës.

NENI 24 - KOMPETENCAT

1. Bordi i Federatës, mes tjerash, kryen funksionet në vijim:

1.1. Merr vendimin për konvokimin e mbledhjes së Kuvendit dhe propozon rendin e ditës për të;

1.2. Harton dhe propozon ndryshimet dhe plotësimet e Statutit dhe akteve tjera që i miraton Kuvendi;

1.3. Nxjerr Rregulloren për licencimin e klubeve dhe shkollave të basketbollit;

1.4. Ekzekuton vendimet, konkluzionet dhe politikat e përgjithshme të miratuara nga Kuvendi;



- 1.5.** Nxjerr rregullore tjera të brendshme që nuk janë në kompetencë të Kuvendit të Federatës;
- 1.6.** Përpilon planin e punës dhe planin financiar vjetor të Federatës;
- 1.7.** Emëron dhe shkarkon Sekretarin e Përgjithshëm të Federatës;
- 1.8.** Emëron dhe shkarkon Komesarin/ët e Garave. Komesari/ët e Garave do të votohen nga Bordi pas çdo edicioni, pas raporteve të punës;
- 1.9.** Emëron dhe shkarkon Drejtorët në Federatë;
- 1.10.** Formon trupa punuese të veta dhe emëron dhe shkarkon anëtarët e tyre. Sipas nevojës edhe miraton Rregulloret përkatëse për këta trupa punues;
- 1.11.** Përcakton strukturën organizative të Federatës, duke miratuar Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të Federatës;
- 1.12.** Disponon me pasurinë e Federatës;
- 1.13.** Miraton listën e zyrtarëve të autorizuar për ndeshjet e zhvilluara nën ombrellën e Federatës (gjyqtarë, vëzhgues, kontrollorë) dhe cakton lartësinë e taksës për zyrtarët e ndeshjeve;
- 1.14.** Miraton propozicionet dhe kalendarin e garave;
- 1.15.** Shqyrton dhe miraton plan programin e Këshillit Profesional dhe Rregulloren për Përfaqësueset e Kosovës në basketboll;
- 1.16.** Bartë të drejtën e organizimit të garave nën kompetencë Federatës;
- 1.17.** Miraton Rregulloren e Garave të Federatës dhe cakton lartësinë e kootizimit për klubet dhe lartësinë e pagesave për shërbimet të cilat i kryen Federata për klubet;
- 1.18.** Miraton Rregulloren për Kalimin dhe Regjistrimin e Lojtarëve;
- 1.19.** Miraton Rregulloren Disiplinore;



- 1.20.** Miraton sistemin e garave për të gjitha kategoritë;
- 1.21.** Nominon klubet - ekipet që garojnë në gara ndërkombëtare në të gjitha grup moshat dhe të dyja gjinitë;
- 1.22.** Mban të drejtën e përjashtimit nga garat vendore dhe pezullimit të anëtarësisë në federatë për klubet që marrin pjesë në gara ndërkombëtare pa lejen e Bordit, gara ndërkombëtare që nuk njihen nga FIBA dhe gara tjera vendore ose ndërkombëtare ku FBK nuk përfaqësohet zyrtarisht;
- 1.23.** Themelon Komitetin Ekzekutiv të Federatës;
- 1.24.** Miraton Rregulloren mbi të drejtat dhe transmetimet audio vizuale;
- 1.25.** Miraton Rregulloren për agjentë/kompanitë e kontraktuara për sponsorizim të FBK-së;
- 1.26.** Vendos për pranimin e punëtorëve dhe bashkëpunëtorëve për kryerjen e punëve të përhershme dhe përkohshme në Federatë, dhe lartësinë e pagave të tyre;
- 1.27.** I raporton Këshillit Mbikëqyrës mbi veprimtarinë e vet dhe mbarëvajtjen ligjore dhe financiare të Federatës, së paku dy herë në vit;
- 1.28.** Miraton Rregulloren për Shpalljen e Laureatëve të Vitit në Basketboll;
- 1.29.** Miraton Rregulloren e Anti-Dopingut;
- 1.30.** Miraton Politikat Mbrojtëse të FBK-së, dhe
- 1.31.** Miraton Kodin Etik të FBK-së.

2. Bordi mund të kryejë edhe funksione tjera të cilat i delegohen nga Kuvendi, si dhe të gjitha funksionet të cilat shprehimisht me këtë Statut apo me aktet tjera normative të Federatës apo me legjislacionin në fuqi nuk i delegohen Kuvendit të Federatës apo ndonjë organi tjetër kompetent.



NENI 25 - TRUPAT PUNUES

1. Bordi mund të formojë trupa punuese (Këshilla dhe Komisione) të përhershme apo përkohshme, tek të cilat mund t'i delegojë kompetencat e veta. Në raste të tilla, Bordi emëron dhe shkarkon sipas vlerësimit të vet anëtarët e këtyre trupave dhe përcakton kompetencat dhe kohëzgjatjen e ekzistimit të tyre. Këto trupa punuese për veprimtarinë e tyre i përgjigjen Bordit.

2. Funkcionimi, mandati, procedurat, dhe autorizimet në lidhje me veprimtarinë e këtyre trupave punues do të rregullohen me Rregulloren mbi Punën e Bordit, si dhe rregulloret përkatëse për këto trupa.

3. Trupa të përhershme punuese të Bordit janë:

3.1. Këshilli Profesional;

3.2. Komisioni për Licencim;

3.3. Komisioni i Garave, mandati i të cilit zgjatë vetëm një edicion garues, me mundësi ri-emërimi;

3.4. Komisioni për Nominimin e Personave Zyrtarë të Ndeshjeve, mandati i të cilit zgjatë vetëm një edicion garues, me mundësi ri-emërimi.

KREU VII. KOMITETI EKZEKUTIV I FEDERATËS

NENI 26 - ANËTARËT, VEPRIMTARIA DHE KOMPETENCAT

1. Komiteti Ekzekutiv zgjidhet nga Bordi dhe përbëhet nga tre deri në pesë anëtarë: Kryetari, Sekretari i Përgjithshëm dhe një deri tre anëtarë të cilët zgjidhen nga Bordi.

2. Komiteti Ekzekutiv i Federatës udhëheq me punën e Federatës në periudhën ndërmjet dy mbledhjeve të Bordit dhe merret kryesisht me operacionet ditore, komerciale dhe financiare të FBK-së.



3. Komiteti Ekzekutiv, ndër të tjera, kryen edhe funksionet në vijim:

3.1. mbikëqyrë në baza javore aktivitetin financiar të FBK-së dhe pasqyrat financiare;

3.2. negocion marrëveshjet e sponsorizimit, marrëveshjet komerciale, marrëveshjet për furnizim dhe marrëveshjet tjera me karakter financiar dhe reprezentativ të FBK-së, të cilat ia dërgon Bordit për miratim;

3.3. vendosë për përfaqësimin e FBK-së në vizita dhe ngjarje zyrtare në rast të ftesës nga ndonjë federatë ose ligë ndërkombëtare, dhe i propozon për miratim Bordit të FBK-së përfaqësimin për ndeshjet e fazave kualifikuese ose finale të kampionateve evropiane ose botërore të të gjitha grup moshave dhe të dyja gjinive;

3.4. miraton dhe mbikëqyr projektet, memorandumet dhe aktet e tjera të bashkëpunimit me MKRS, KOK dhe donatorë e partnerë të tjerë dhe për zbatueshmërinë e tyre i raporton Bordit;

3.5. vendos për çështje urgjente, që nuk janë kompetencë ekskluzive e Bordit ose Kuvendit;

3.6. harton Rregulloren për Marketing për ligat e caktuara, që pas miratimit në Bord bëhet obligative për klubet dhe anëtarët tjerë FBK-së.

4. Komiteti Ekzekutiv mblidhet së paku një herë në muaj. Me propozim të Kryetarit, Komiteti Ekzekutiv mund të realizojë votimin për çështje të caktuara edhe nga distance (tele-konferenca, vota me email ose forme tjetër e komunikimit e dakorduar paraprakisht).

5. Komiteti Ekzekutiv për punën e vet i raporton Bordit të FBK-së në baza tre mujore, ose me dinamik tjetër nëse kërkohet nga Bordi.



KREU VIII. KRYETARI I FEDERATËS

NENI 27 - ZGJEDHJA DHE MANDATI I KRYETARIT

- 1.** Kryetarin e Federatës e zgjedhë Kuvendi me mandat katër (4) vjeçar, sipas ciklit olimpik të Lojërave Olimpikë Verore. Kryetari i Federatës është edhe Kryetar i Bordit dhe Kryetar i Kuvendit të Federatës. Për punën e vet, Kryetari i përgjigjet drejtpërdrejt Kuvendit të Federatës.
- 2.** Kandidatët për Kryetar të Federatës mund të propozohen nga:
 - 2.1.** Bordi i Federatës, i cili mund të propozojë një kandidat; dhe
 - 2.2.** shtatë (7) anëtarë të Kuvendit, në pajtim me këtë Statut, të cilët me deklaratë me shkrim drejtuar Bordit dhe Sekretarit të Përgjithshëm kandidojnë një kandidat për Kryetar.
- 3.** Kryetari mund të zgjidhet me aklamacion, me votim të hapur apo votim të fshehtë. Modalitetin e votimit për zgjedhjen e Kryetarit e përcakton Kuvendi me shumicë votash.
- 4.** Në rast të zgjedhjes me votim, Kryetar i Federatës konsiderohet kandidati që ka fituar së paku një votë më shumë se gjysma e votave të delegatëve të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit. Në qoftë se asnjëri nga kandidatët e propozuar për Kryetar nuk e merr këtë numër të votave, atëherë në rrethin në rrethin e dytë të votimit delegatët e Kuvendit votojnë për dy (2) kandidatët të cilët në rrethin e parë kanë marrë numrin më të madh të votave. Pas votimit në rrethin e dytë, për Kryetar zgjidhet kandidati i cili ka fituar numrin më të madh të votave.
- 5.** Kuvendi mund ta shkarkojë Kryetarin edhe para skadimit të mandatit, në qoftë se vërtetohet se ka punuar në kundërshtim me Statutin dhe aktet e tjera normative të Federatës. Pas shkarkimit të Kryetarit, Kuvendi zgjedh Kryetarin e ri sipas procedurës së parashikuar me këtë Statut, në mbledhjen e Kuvendit e cila duhet të thirret brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e shkarkimit të Kryetarit.



NENI 28 - KOMPETENCAT

1. Kryetari, mes tjerash, kryen detyrat në vijim:

- 1.1.** Përfaqëson Federatën në Kosovë dhe jashtë vendit;
- 1.2.** Konvokon dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit të Federatës;
- 1.3.** Konvokon dhe kryeson mbledhjet e Bordit, dhe udhëheq punën e tij;
- 1.4.** Siguron realizimin e programeve, planeve dhe konkluzioneve të Kuvendit dhe Bordit;
- 1.5.** Siguron ligjshmërinë e veprimtarisë së Federatës;
- 1.6.** Është urdhërdhënës dhe përgjegjës për realizimin e planit financiar;
- 1.7.** Nënshkruan aktet e miratuara nga Kuvendi dhe Bordi;
- 1.8.** Mbikëqyr përgatitjen e materialeve të nevojshme për mbledhjet dhe punën e Kuvendit dhe Bordit;
- 1.9.** Zbaton dhe udhëheq politikat e Federatës;
- 1.10.** Siguron mbarëvajtjen financiare dhe operacionale të Federatës dhe mund të nxjerr vendime lidhur me këtë.

2. Kryetari kryen edhe punë tjera që rrjedhin nga ky Statut, vendimet e Kuvendit apo legjislacioni në fuqi.

KREU IX. SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

NENI 29 - EMËRIMI DHE MANDATI I SEKRETARIT

1. Sekretarin e Përgjithshëm të Federatës e emëron Bordi për një mandat katër (4) vjeçar me mundësi të riemërimit. Sekretari i Përgjithshëm themelon marrëdhënie pune me Federatën me afat të caktuar prej katër (4) vitesh, në bazë të ligjit të zbatueshëm të punës në Kosovë.



2. Sekretari i Përgjithshëm i Federatës mund të shkarkohet nga Bordi edhe para skadimit të mandatit të paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, në rast se Bordi konstaton se i njëjti ka kryer shkelje ligjore, të këtij Statuti apo akteve tjera normative të Federatës.

3. Kriteret, kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të emërimit dhe shkarkimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Federatës i përcakton Bordi i Federatës në Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të Federatës.

NENI 30 - KOMPETENCAT

1. Sekretari i Përgjithshëm, mes tjerash, kryen detyrat në vijim:

1.1. Përfaqëson Federatën, në bazë të autorizimeve të Bordit dhe Kryetarit të Federatës;

1.2. Është urdhërdhënës për realizimin e planit financiar;

1.3. Udhëheq dhe është përgjegjës për punën e zyrës së Federatës;

1.4. Kujdeset dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e punës në Federatë;

1.5. Kujdeset për ekzekutimin e vendimeve dhe konkluzioneve të Bordit dhe trupave punuese;

1.6. Përgatit materialet për mbledhjet e Kuvendit dhe Bordit, nën mbikëqyrjen e Kryetarit;

1.7. Kryen detyra tjera me të cilat e ngarkon Bordi;

1.8. I propozon Bordit formimin e trupave punuese;

1.9. Realizon bashkëpunimin me FIBA, Federatat e Basketbollit dhe organizatat e tjera sportive jashtë Kosovës;

1.10. Realizon bashkëpunimin me KOK-un, MKRS-në, Departamentin e Sporteve të Kosovës dhe organizatat e tjera sportive të Kosovës;



1.11. Merr pjesë në të gjitha mbledhjet e organeve dhe trupave punuese të Bordit në cilësinë e këshillëdhënësit;

1.12. Mbanë kontakte me mjetet e informimit;

1.13. Ndhmon në hartimin e rregulloreve dhe akteve normative që miratohen nga Kuvendi dhe Bordi i Federatës;

1.14. I propozon Bordit profilin e bashkëpunëtorëve administrativo-profesional;

1.15. Interpretet aktet normative të Federatës që miratohen nga Bordi i Federatës;

1.16. Siguron përkrahje profesionale dhe administrative për Kuvendin, Bordin, Këshillin Mbikëqyrës dhe organet tjera të Federatës, sipas nevojës.

2. Kryen edhe punë të tjera të cilat dalin nga aktet normative të Federatës apo të cilat i delegohen nga Kuvendi apo Bordi i Federatës.

KREU X. KËSHILLI MBIKËQYRËS

NENI 31 - ANËTARËT DHE VEPRIMTARIA

1. Këshilli Mbikëqyrës është organ mbikëqyrës i Federatës, i cili përbëhet nga tre anëtarë, të zgjedhur nga Kuvendi i Federatës me mandat katër (4) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.

2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të jenë anëtarë të organeve dhe trupave punuese tjera të Federatës. Bordi, Sekretari i Përgjithshëm dhe të gjitha trupat punuese të tija janë të obliguara që Këshillit mbikëqyrës t'ia mundësojnë mbikëqyrjen e punës së tyre.

3. Këshilli mbikëqyrës e përcjell ligjshmërinë e punës së Bordit dhe trupave punuese mes të dy Kuvendeve dhe mbikëqyr afarizmin financiar të Federatës. Këshilli Mbikëqyrës i raporton për punën e vet Kuvendit të Federatës.



4. Metoda dhe modalitetet e punës së Këshillit Mbikëqyrës përcaktohen me Rregulloren e Punës së Këshillit Mbikëqyrës të cilin e miraton Kuvendi i Federatës.

KREU XI. KËSHILLI PROFESIONAL

NENI 32 - VEPRIMTARIA, ANËTARËT DHE KOMPETENCAT

1. Veprimtaria themelore e Këshillit Profesional, si trup punues profesional i Bordit, është avancimi i punës profesionale në Federatë veçanërisht me Përfaqësueset e Federatës.

2. Këshilli Profesional inicion dhe nxit aktivitete për zgjidhjen e çështjeve të cilat janë në dobi të zhvillimit dhe ngritjes së cilësisë së basketbollit nëpërmjet bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me klubet dhe shoqatat profesionale të Federatës.

3. Këshilli Profesional numëron 3-5 anëtarë, të cilët i emëron Bordi. Anëtarë të Këshillit Profesional mund të jenë ish-basketbollistët e shquar, trajnerë, mjekë, gazetarë sportivë, etj. Mandati i Këshillit Profesional zgjat katër (4) vjet, me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një (1) mandat.

4. Këshilli Profesional për punën e vet i përgjigjet Bordit, ndërsa në kompetenca të tij janë, mes tjerash, detyrat në vijim:

4.1. Përcjell zhvillimin e basketbollit brenda Kosovës dhe përcjellja dhe mbikëqyrja e realizimit të plan programeve profesionale të aprovuara nga Bordi;

4.2. Bashkëpunimi me organizata profesionale dhe shkencore, me qëllim të avancimit të punës profesionale në basketboll;

4.3. Zhvillimi i profesionalizmit dhe popullarizimi i basketbollit në Kosovë;

4.4. Parashtrimi i propozimeve për emërim dhe shkarkim të trajnerëve të përfaqësueseve të Kosovës në basketboll për Bordin;

4.5. Përkrahja e avancimit profesional të kuadrove të basketbollit;



4.6. Hartimi dhe propozimi i plan programeve për zhvillimin e basketbollit për grup moshat e reja, për miratim të Bordit;

4.7. Propozimi i sistemit të garave për të gjitha kategoritë;

4.8. Kryerja e punëve tjera të cilat i ngarkohen nga Bordi.

5. Anëtarë e Këshillit Profesional, apo i tërë Këshilli Profesional, mund të shkarkohen edhe para skadimit të mandatit të tyre nëse vërtetohet se nuk i kanë kryer detyrat me përgjegjësi apo nëse kanë vepruar në kundërshtim me këtë Statut apo me aktet tjera normative të Federatës. Në rast të tillë, anëtarët përkatës apo tërë Këshilli Profesional do të zëvendësohen me anëtarë të rinj, sipas procedurës së përcaktuar për zgjedhjen e tyre.

NENI 33 - SHOQATA E BASKETBOLLISTËVE DHE SHOQATAT E TRAJNERËVE DHE GJYQATARËVE TË BASKETBOLLIT

1. Shoqata e Basketbollistëve, Shoqata e Trajnerëve të Basketbollit dhe Shoqata e Gjyqtarëve të Basketbollit, si entitete profesionale dhe anëtare të Federatës, zbatojnë politikën e veprimtarisë së tyre në pajtueshmëri me aktet e tyre normative, dhe me Statutin dhe aktet tjera normative të Federatës.

2. Këto shoqata janë të pavarura në kryerjen e veprimtarisë së tyre nëpërmjet organeve drejtuese të zgjedhura në përputhje me aktet e tyre normative, mirëpo nuk mund të gëzojnë të drejtat dhe statusin e Federatës së degës sportive.

3. Shoqata Basketbollistëve, Shoqata e Trajnerëve të Basketbollit dhe Shoqata e Gjyqtarëve të Basketbollit do të gëzojnë përkrahje nga Federata. Rrjedhimisht, do t'i raportojnë me shkrim Bordit lidhur me veprimtarinë dhe shpenzimet e hasura gjatë realizimit të veprimtarisë, së paku një herë në vit.

4. Shoqata Basketbollistëve, Shoqata e Trajnerëve të Basketbollit dhe Shoqata e Gjyqtarëve të Basketbollit i parashetrojnë para Bordit plan programet e punës dhe kërkesat për përkrahje në realizimin e tyre dhe mund të kërkojnë nga Bordi ndërmarrjen e masave për të zgjidhur çështje të caktuara të cilat pamundësojnë funksionimin normal dhe të suksesshëm të tyre.



KREU XII. PERSONI KONTAKTUES PËR INTEGRITET (SPOC) NË FEDERATËN E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

NENI 34 - EMËRIMI DHE DETYRAT KRYESORE

1. Personi kontaktues për integritet (SPOC) në Federatën e Basketbollit të Kosovës duhet të jetë një individ me pozitë zyrtare (i emëruar zyrtarisht si SPOC i FBK-së nga Bordi Ekzekutiv) brenda Federatës. Megjithatë, kur SPOC-u trajton një sërë aktivitete që shkojnë përtej përgjegjësive bazë të përshkruara në udhëzime, këto aktivitete mund të mbështeten/ndahen me anëtarë të tjerë të Federatës që merren me çështjet e integritetit. SPOC-u gjithashtu mund të jetë drejtues ose anëtar i ndonjë Njësie për Integritet.

2. Detyra kryesore e SPOC-ut është të jetë ndërmjetësuesi kryesor për çështjet e integritetit në mes të Federatës dhe anëtarëve të saj, si dhe me akterët e jashtëm. SPOC-u mund të merr edhe detyra tjera shtesë, nëse organizata e sheh si të nevojshme këtë.

3. Përgjegjësia e SPOC-ut është të merret me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me manipulimin e garave, si dhe me integritetin e Federatës. Çështjet e tjera që kanë të bëjnë me integritet mund të jenë gjithashtu pjesë e portofolios së SPOC-ut. Edhe sipas Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC), puna e personave kontaktues për integritet përqendrohet kryesisht në parandalimin e manipulimit të garave.

4. Përkufizimi i përgjithshëm i Personit Kontaktues për Integritet (SPOC) në FBK: ***“Individi i/e caktuar nga organizata e tij/saj sportive si ndërmjetës(e) kryesor(e) me akterë të jashtëm për çështjet që përcaktojnë integritetin, duke përfshirë Manipulimin e Garave dhe Integritetin e Organizatës”.***

KREU XIII. FINANCIMI I FEDERATËS

NENI 35 - FINANCIMI DHE TË DREJTAT E TRANSMETIMIT AUDIO-VIZUAL

1. Federata posedon mjetet e veta financiare dhe pasurinë e saj me të cilat disponon në mënyrë të papenguar. Përgjegjës për mbarëvajtjen financiare të Federatës janë Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i Federatës, të cilët



gëzojnë nivele të ndryshme të autorizimeve sa u përket realizimit të pagesave për nevoja të Federatës.

2. Nivelet përkatëse të autorizimit do të përcaktohen me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të Federatës.

3. Burimet financiare të Federatës janë:

3.1. Pagesat për anëtarësi në Federatë;

3.2. Pagesat e kootizimit të klubeve;

3.3. Të hyrat nga organizimi i garave;

3.4. Donacionet dhe grantet nga autoritetet publike dhe subjektet private;

3.5. Të hyrat nga transmetimet audio-vizuale të ndeshjeve të organizuara nën ombrellën e garave të Federatës;

3.6. Të gjitha burimet tjera të financimit të lejuara me ligj.

4. Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) është pronare e vetme e të drejtave të transmetimit audio-vizual të ndeshjeve të organizuara në garat e organizuara nën ombrellën e Federatës. Federatat ka të drejtën e menaxhimit, shitjes, rishitjes në mënyrë vetanake ose në partneritet me ndonjë biznes tjetër, të këtyre të drejtave, me qëllim që mjetet e grumbulluara në këtë mënyrë të shfrytëzohen për avancimin e qëllimeve të përcaktuara me këtë Statut. Mjetet e grumbulluara nga shitjet e tilla do të ndahen me klubet anëtare të Federatës, në bazë të formulave të përcaktuara me aktin normativ të Federatës mbi ndarjen e të hyrave nga transmetimet audio-vizuale, e cila do të miratohet nga Bordi i Federatës.

5. Para hartimit të aktit normativ mbi transmetimet audio-vizuale, sipas paragrafit 3 të këtij neni, dhe para lidhjes së çfarëdo marrëveshjeje me transmetuesit audio vizual, Bordi i Federatës do të konsultohet me të gjitha klubet përfituese dhe do të merr pëlqimin e shumicës së tyre.

6. Realizimi i të hyrave dhe shpenzimeve kryhet sipas planit financiar të miratuar paraprakisht nga Kuvendi i Federatës. Veprimtarinë materiale-financiare ditore e udhëheq Sekretari i Përgjithshëm, i përkrahur nga një



referent financiar, i cili angazhohet për kryerjen e shërbimeve përkatëse nga Bordi për një afat të caktuar.

KREU XIV. GARAT

NENI 36 - GARA ZYRTARE

1. Gara zyrtare në sportin e basketbollit në Kosovë mund të organizohen vetëm nga Federata, ose organi i autorizuar nga Bordi i Federatës.
2. Garat zhvillohen në bazë të Rregullave zyrtare të FIBA-s dhe rregullave dhe akteve të Federatës. Në udhëheqjen e garave, organi përkatës i garave duhet t'i respektojë të gjitha vendimet e FIBA-s.
3. Kalendarin dhe Propozicionet e garave të Kampionatit dhe të Kupës Kombëtare i miraton Bordi i Federatës.

KREU XV. PËRFAQËSUESET SHTETËRORE

NENI 37 - PUNA PËR PËRFAQËSUESET SHTETËRORE

1. Federata është e obliguar të kujdeset për punën e përfaqësueseve dhe t'u mundësojë kushte sa më të mira për punë. Paraqitja për përfaqësuesen e Kosovës është obligim dhe nder për çdo anëtar të saj.

KREU XVI. SHËRBIMI ADMINISTRATIVO-PROFESIONAL

NENI 38 - FUNKSIONIMI I SHËRBIMIT ADMINISTRATIVO-PROFESIONAL

1. Federata mund të themelojë marrëdhënie të punës në afat të caktuar me punëtorët të cilët do të punojnë dhe kryejnë shërbime profesionale, administrative dhe financiare për Federatën.
2. Punësimi i punonjësve, lartësia e pagave të tyre dhe modalitetet dhe përgjegjësitë e punonjësve të Federatës do të përcaktohen me Rregulloren



për Organizimin e Brendshëm të Federatës, e cila miratohet nga Bordi i Federatës.

3. Punonjësit administrativo-profesional të Federatës të drejtat dhe obligimet e tyre nga marrëdhënia e punës i realizojnë në bazë të Ligjit mbi marrëdhënie të punës të zbatueshëm në Kosovë.

4. Mjetet e ndara për pagesën e punonjësve administrativo-profesional të Federatës përcaktohen në planin financiar të Federatës.

KREU XVII. RREGULLORET E BRENDSHME

NENI 39 - MOS-NDRYSHIMI I RREGULLOREVE GJATË EDICIONIT

1. Rregulloret e brendshme të cilat kanë të bëjnë me garat zyrtare të Federatës si dhe Propozicionet e Garave nuk mund të pësojnë ndryshime gjatë edicionit garues i cili është në rrjedhë e sipër.

NENI 40 - PROCEDURAT ADMINISTRATIVE

1. Në procedurat administrative të cilat zhvillohen pranë organeve të Federatës mund të përdoren mjetet e rregullta dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike.

2. Për çështjet administrative të cilat nuk janë rregulluar me këtë Statut apo me aktet tjera normative të Federatës, do të aplikohen dispozitat përkatëse të Ligjit për procedurën administrative.

KREU XVIII. PUSHIMI I VEPRIMTARISË SË FEDERATËS

NENI 41 - PUSHIMI I AKTIVITETIT DHE SHPËRNDARJA E PASURISË

1. Federata pushon punën e saj kur për këtë deklarohen 2/3 e anëtarëve të anëtarësuar në Federatë, ose sipas Ligjit.

2. Në rast të pushimit të veprimtarisë së Federatës, atëherë e tërë pasuria e saj (aktive dhe pasive) i kalon organizatës e cila i merr përsipër të drejtat dhe



detyrat e Federatës. Organizata e re duhet të ketë qëllime dhe obligime të ngjashme.

KREU XIX. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

NENI 42 - PËRGJEGJËSITË NDAJ PARANDALIMIT DHE SANKSIONIMIT TË DHUNËS DHE DUKURIVE NEGATIVE NË NGJARJET SPORTIVE

1. Federata e Basketbollit të Kosovës i njeh dhe i kupton të gjitha përgjegjësitë që i përcaktohen me ligjin përkatës në Republikën e Kosovës sa i përket zhvillimit të sportit dhe veçanërisht organizimit të ngjarjeve sportive në një ambient të përshtatshëm dhe të favorshëm për të gjithë, pa dhunë, dhe dukuri tjera negative, duke ofruar standarde të larta të rendit, sigurisë dhe shërbimeve, si dhe zhvillimin e tyre në përputhje me vlerat qenësore dhe parimet e sportit. Organet e FBK-së, e veçanërisht Komisioni i Garave, do të bashkëpunojnë ngushtë me trupat/organet përkatëse shtetërore.

NENI 43 - MËNJANIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT

1. Asnjë anëtarë i organit drejtues nuk lejohet të marr pjesë në diskutim apo në marrjen e vendimit për çështje kur ai/ajo ka interes privat të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, personal apo pasurorë, të cilat ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij/saj gjatë ushtrimit të funksionit.

2. Konflikt i interesit sipas këtij Statuti konsiderohet ashtu siç është përcaktuar dhe paraparë me ligjin në fuqi.

NENI 44 - MIRATIMI DHE HARMONIZIMI ME KËTË STATUT

1. Organet e Federatës janë të obliguara t'i miratojnë dhe harmonizojnë aktet normative përkatëse me këtë Statut në afatin prej më së largu 90 ditë nga dita e aprovimit të këtij Statuti.



NENI 45 - INTERPRETIMI I STATUTIT

1. Interpretimin zyrtar të këtij Statuti e bënë Kuvendi.

NENI 46 - DISPOZITA KALIMTARE

1. Struktura dhe numri i anëtarëve të Bordit, sipas ndryshimeve të nenit 22 të miratuara me amendamentet e datës 23.03.2026, kanë karakter të përkohshëm dhe vlejnë ekskluzivisht për mandatin aktual 2024-2028. Me përfundimin e këtij mandati, dispozitat e nenit 22 që rregullojnë përbërjen dhe mënyrën e konstituimit të Bordit rikthehen automatikisht në formulimin e mëparshëm, pa qenë i nevojshëm miratim i ri nga Kuvendi, sipas të cilit *'Bordi numëron gjithsej 13 anëtarë dhe përbëhet nga: Kryetari, dy (2) nënkryetarë dhe dhjetë (10) anëtarë. Së paku një anëtar i Bordit duhet të jetë përfaqësues i sportistëve. Kryetari, dy (2) nënkryetarët dhe shtatë (7) anëtarë të Bordit i zgjedhë Kuvendi me shumicë votash. Së paku një nga anëtarët e Bordit të zgjedhur nga Kuvendi duhet të jetë e gjinisë femërore. Tre (3) anëtarë të Bordit, nga të cilët së paku një i gjinisë femërore, emërohen dhe shkarkohen me vendim të Kryetarit të Federatës pas marrjes së postit të Kryetarit. Mandati i anëtarëve të Bordit të emëruar nga Kryetari i Federatës është i lidhur me mandatin e Kryetarit të Federatës, që do të thotë se mandati i tyre pushon në rast të pushimit të mandatit të Kryetarit të Federatës për çfarëdo arsye.'*

NENI 47 - HYRJA NË FUQI

1. Ky Statut hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Federatës. Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti pushojnë të vlejnë të gjitha Statutet e miratuara më parë.

KUVENDI I FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Kryetari

Arben **FETAHU**

Prishtinë, 23.03.2026

